

# #WePROTECT children Online

## DEKLARATA PËR VEPRIM E QEVERIVE PËR TË TRAJTUAR CSE-në ONLINE: SAMITI I ABU DABIT WEPROTECT 16-17 NËNTOR 2015

Ne, udhëheqësit e shteteve dhe organizatave ndërkombëtare të mbledhura në Emiratet e Bashkuara Arabe, besojmë se shfrytëzimi seksual online i fëmijëve është një krim i neveritshëm që kërkon një përgjigje globale të koordinuar.

Ne e ripohojmë dhe nënshkruajmë Deklaratën për Veprim të Samitit të Londrës WePROTECT, të mbajtur në dhjetor 2014, i cili përcakton angazhimin tonë për të ndërmarrë veprime për identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave, për të hequr materialet e abuzimit seksual të fëmijëve nga interneti dhe për të forcuar bashkëpunimin për të gjurmuar autorët e këtij abuzimi. Por, tashmë ne duam të shkojmë më tej.

Për t'i dhënë fund kësaj situate, ne mbështesim rekomandimet e Bordit Këshillimor Ndërkombëtar WePROTECT dhe biem dakord për të vendosur dhe zhvilluar, në shtetet tona, përgjigjen e koordinuar kombëtare ndaj shfrytëzimit seksual online të fëmijëve, të udhëhequr nga Modeli Kombëtar i Përgjigjes WePROTECT, që do të garantojë:

- ✚ Nivelin më të lartë të përgjigjes kombëtare ndaj shfrytëzimit seksual të fëmijëve online, duke përfshirë parandalimin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve;
- ✚ Programe efektive parandalimi, hetime dhe ndjekje penale, mbrojtjen e viktimave dhe menaxhimin e shkelësve;
- ✚ Shërbime mbështetjeje të përshtatshme për fëmijët dhe të rinjtë;
- ✚ Legjislacion ose politika që do të mbështesin përpjekjet e kompanive teknologjike për të hequr materialet e abuzimit seksual të fëmijëve nga interneti, nëpërmjet zhvillimit të zgjidhjeve teknologjike;
- ✚ Rritjen e ndërgjegjësimit dhe mirëkuptimit ndërmjet publikut dhe profesionistëve që punojnë me fëmijët.

Në mbështetje të kësaj, ne zotohemi të:

- ✚ Zhvillojmë përgjigjet kombëtare duke krijuar struktura shumë-palëshe që bëjnë bashkë të gjithë ata që janë përgjegjës për mbrojtjen online të fëmijëve;
- ✚ Botojmë një analizë të përgjigjes sonë kombëtare, duke përfshirë zbatimin e zotimeve WePROTECT, dhe përdorimin e saj për të forcuar kapacitetet tona;
- ✚ Përdorim njohuritë dhe burimet e ndara të komunitetit WePROTECT për të zhvilluar përgjigjen kombëtare, duke kërkuar mbështetje nga Fondi Global për t'i Dhënë fund Dhunës Ndaj Fëmijëve dhe duke koordinuar mbështetjen tonë për forcim kapacitetesh nw nivlein e duhur.

Ne e kuptojmë nevojën për ta mbështetur WePROTECT si një iniciativë ndërkombëtare për të përmirësuar kapacitetet globale për trajtimin e shfrytëzimit seksual online të fëmijëve dhe kemi rënë dakord për të:

- ✚ Mbështetur krijimin, në mars 2016, të një Bordi Këshillimor, të mbështetur nga një sekretariat, përgjegjës për të gjithë ata që janë angazhuar në iniciativën WePROTECT, dhe që do të mbështesin zbatimin e zotimeve të bëra në Samitin e Londrës dhe Abu Dabit dhe që do të mbikëqyrin zhvillimin e mëtejshëm të kësaj iniciative;

🚩 Organizuar takime një herë në dy vite në nivel ministror për rishikimin e progresit tonë dhe për të rënë dakord në lidhje me veprimet për trajtimin e kërcënimeve të shfaqura ndaj fëmijëve nga shfrytëzimi seksual online;

🚩 Përfaqësuar rëndësinë e trajtimit të shfrytëzimit seksual online të fëmijëve dhe të iniciativës WePROTECT brenda të gjitha forumeve globale përkatëse.

Miraturar nga:

Shqipëria

Australia

Austria

Bosnje & Hercegovina

Bullgaria

Kamboxia

Kanadaja

Republika Kineze

Kolumbia

Kosta Rika

Estonia

Finlanda

Franca

Gana

Hungaria

Indonezia

INTERPOL

Irlanda

Italia

Japonia

Jordania

Mbretëria e Arabisë Saudite

Kosova

Kuvajt

Mali i Zi

Nepali

Holanda

Zelanda e Re

Peruja

Filipinet

Republika e Koresë

Rumania

Ruanda

Slovakia

Spanja

Zvicra

Sudani

Emiratet e Bashkuara Arabe

Uganda

Mbretëria e Bashkuar

UNODC

SHBA-të

Vietnam

